



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 40, datë 27. 06. 2022

**“PËR PJESËMARRJEN E BASHKISË SKRAPAR, NË SUBJEKTE ME
KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE
TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE
TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 27. 06. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të nenit 9, nenit 14, pika 1 dhe 5 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14. 04. 2008, "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar, VKM Nr. 302, datë 11. 05. 2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura"

VENDOSI:

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Skrapar, që në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të negociojë me Bashkinë Berat, Bashkinë Kuçovë, Bashkinë Poliçan, Bashkinë Dimal, që kanë në pronësi shoqëritë publike të Ujësjetllës Kanalizimeve, që aktualisht ushtrojnë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura në Republikën e Shqipërisë si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë e lidhjes së marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta (SKP), për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Skrapar, në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i "Sh. a. Ujësjetllës Kanalizime Skrapar", që pas krijimit të Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, ku bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare "Sh. a. Ujësjetllës Kanalizime Skrapar", për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktual dhe notarial me qëllim transferimin e veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK, që do të krijohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Skrapar
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 8 vota pro, vota kundër - s'ka, vota abstenim - s'ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

